



Nr. regj. 24908/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Ali(Hamzë) Podrimja, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6 par. 2 të ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 27.10.2011 merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Ali (Hamzë) Podrimja, i lindur më datë 01.08.1942 në Gjakovë, me vendbanim në Lagjën Ulpiana, Rruga "Mark Dizdari" Hyrja D-7/1 nr. 18, në Prishtinë, akademik, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i padënuar,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik, anëtar i Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2011, në Agjencinë kundër korrupsionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 6 par. 2 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj

D Ë N O H E T

Me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. PAGESA bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet të pandehurit me dënim burgu në kohëzgjatje prej **20(njëzet) ditësh**, duke llogaritur për çdo **15 € nga 1(një) ditë burgu**.

Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguaj shumën prej nga **5 €, në afat dhe xhironlogari të njëjtë me gjobën**.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën nr. 01-3196/2011 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Ali Podrimja, për kundërvajtjen nga neni 6 paragrafi 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka pas dijeni se edhe anëtarët e bordit konsiderohen Zyrtarë të lartë publik dhe se duhet ta deklarojnë pasurinë, ka udhëtuar në atë kohë në Greqi lidhur me promovimin e librit të tij dhe lidhur me një debat politik për Kosovën, atje ka qëndruar 10 ditë,

ka shkuar para 31 marsit, andaj me datë 31 mars 2011 nuk ka qenë në Kosovë. Lut gjykatën ta ketë parasysh se është i moshuar dhe se ka harruar se duhet ta deklaronte pasurin. Gjykatës i ka prezantuar kopjen e faqeve të pasaportës lidhur me atë se më datën 31.03.2011 nuk ka qenë në Kosovë, por jashtë shtetit si dhe Vërtetimin me numër të protokollit 03-3629/11 të datës 13.09.2011 i lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit se ka dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, shikimit të pasaportës nr. K00248004 të lëshuar nga Ministria e punëve të Brendshme, nga e cila shihet vetëm data 03.03.2011, ndërsa data e kthimit nuk shihet, vërtetimi me numër të protokollit 03-3629/11 të datës 13.09.2011 i lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, nga i cili vërtetohet se i njëjti më vonë e ka deklaruar pasurinë në Agjencion si dhe pas vlerësimit të shkresave të tjera të lëndës, secilës shkresë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar këtë gjendje faktike: se i pandehuri si zyrtarë i lartë publik, anëtar i Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2011 në Agjencinë kundër korrupsionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik. I njëjti tenton të arsyetohet se në atë kohë nuk ka qenë në Kosovë, se është i moshuar dhe ka harruar afatin e fundit ligjor, duke tentuar të shmanget përgjegjësisë, andaj gjyqtaria në masë të mjaftueshme vërtetoi se Ali Podrimja, ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, e shpalli përgjegjës dhe e dënoj si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LK, nën të cilat është kryer kundërvajtja, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit duke pas parasysh moshën e tij si dhe shkallën e përgjegjësisë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 24908/2011, më datë 27.10.2011

Gjyqtaria
Azra Caholli

KRIMINAL JURIDIKE Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh. Gjykatës të Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksë.